



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË



Nr. 5666/2 Prot.

Nr. 39215 Prot.  
SI 02.09.2024

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur sot më datë 06/09/2024, në Tiranë, ndërmjet:

**MINISTRISË SË MBROJTJES**, me adresë "Ruga e Dibrës", Tiranë, Shqipëri, këtu e në vijim e quajtur "MM";

dhe

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**, me adresë: "Ruga e Durrësit 23", nr. 1001, Tiranë, Shqipëri, këtu e në vijim e quajtur "MAS";

Individualisht referuar si **PALË** dhe bashkërisht referuar si **PALËT**, synojnë:

- Të mundësojnë bashkëpunimin ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), në kuadrin e programit "Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura" dhe institucioneve arsimore parauniversitare.
- Edukimin e të rinjve me edukim patriotik, atdhetar dhe me njohuri për Forcat e Armatosura, misionin, detyrat, përgjegjësitet.
- T'u japid të rinjve njohuri për mundësitet që ofron FARSH për ta, në arsimimin ushtarak brenda dhe jashtë vendit, si dhe për punësimin e tyre si ushtarakë aktiv në FARSH.
- Palët angazhohen për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, në respektim të legjisacionit që rregullon fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore dhe ato të bashkëpunimit mes institucioneve të administratës shtetërore, duke rënë dakord si vijon:

NENI I

### QËLLIMI

Qëllimi i kësaj marrëveshje është vendosja e formave të bashkëpunimit ndërmjet Palëve, bazuar në fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore, duke bërë të mundur zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për informimin, edukimin patriotik dhe atdhetar, dhënien e njohurive për Forcat e Armatosura si dhe mundësitet që FARSH ofron për ta. Bashkëpunimi ndërmjet palëve do t'i kontribuoj veçanërisht programit të FARSH "Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura të RSH".

NENI 2

### BAZA LIGJORE

Marrëveshja bazohet në ligjin nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; ligjin nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar"; ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 867/2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", i ndryshuar.

NENI 3

### ANGAZHIMET E PALËVE

#### 3.1 Palët angazhohen për të bashkëpunuar me njëra-tjetrën, duke rënë dakord, si më poshtë:

- Të përgjigjen reciprokisht për përbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje, për të qenë partnerë në zhvillimin e njohurive mësimore për FARSH të nxënësve, me fokus të veçantë nxënësit maturantë.
- Të programojnë takime periodike për shkëmbimin e informacionit dhe komenteve mbi projektet e realizuara si dhe, të bashkërendohen në aktivitete/projekte për të ardhmen.
- Të gjejnë dhe vlerësojnë bashkëpunime të mëtejshme në përbushje të përgjegjësive dhe detyrave të tyre funksionale, bazuar në fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore si dhe të mundësojnë bërjen e të rinjve pjesë të forcave aktive në FARSH.
- Të nxisin, mbështesin dhe promovojnë të rintjtë që evidentohen dhe dëshirojnë të jenë pjesë e FARSH.
- Publikimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi në faqet e tyre zyrtare, në mënyrë që të aksesohet menjëherë nga çdo i interesuar.

#### 3.2 Ministria e Arsimit dhe Sportit merr përsipër:

- Të sigurojë akses në institucionet e arsimit parauniversitar dhe në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar për Shtabin e Përgjithshëm të FARSH (strukturave të vartësisë të institucionit të arsimit të lartë, Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Qendrës Personel Rekrutimit), sipas një kalendarit të dakordësuar mes palëve, kalendar i cili përcakton orar/periudha kohore në institucionet e arsimit parauniversitar përmarrjen e njohurive nga FARSH apo zhvillim të aktiviteteve të përbashkëta në struktura (reparte ushtarake).
- Zhvillimin e aktiviteteve promovuese të FARSH në institucionet e arsimit parauniversitar, kryesisht me nxënësit maturantë dhe lejimin e tyre për zhvillimin e aktiviteteve në struktura të FARSH (reparte ushtarake), duke zbatuar rregullat e brendshme të tyre, nga nxënësit/ maturantët.

- c. Zhvillimin e praktikave mësimore të nxënësve në strukturat e Forcave të Armatosura të RSH, sipas specialiteteve.

### **3.3 Ministria e Mbrojtjes merr përsipër:**

- a. Të zhvillojë programin "Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura të RSH" në institucionet e arsimit parauniversitar, sipas kalendarit të dakordësuar ndërmjet institucionit arsimor dhe FARSH (nëpërmjet Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Qendrës së Personel Rekrutimit) apo edhe në strukturat e FARSH, duke zbatuar rregulloret e brendshme të palëve.
- b. Të mundësojë zhvillimin e aktiviteteve të dakordësuara mes palëve në mjediset e institucioneve të arsimit parauniversitar dhe në strukturat e FA.
- c. Të vendosë, në funksion të zhvillimit të aktiviteteve të saj, krahas ambienteve edhe infrastrukturën e nevojshme, armatimin dhe pajisjet ushtarake.
- d. Të evidentojë si kandidatë potencialë të rinjtë, që shprehin dëshirë për studime ushtarake brenda dhe jashtë vendit, apo dëshirë për punësim në strukturat e FARSH.

NENI 4

### **SHPENZIMET**

Të gjitha shpenzimet që lidhen me prodhimin e materialeve promovuese, të nevojshme për aktivitetet që do të kryhen, apo ato që lidhen me transportin e të rinjve/maturantëve për në struktura (reparte ushtarake) dhe anasjelltas, do të kryhen nga Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet strukturave të FARSH: Komandat e Forcave/Mbështetëse, Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Qendrës së Personel Rekrutimit.

NENI 5

### **KOMUNIKIMI**

- a. Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e angazhimeve të tyre, sipas kësaj marrëveshje.
- b. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe/ose nëpërmjet postës elektronike.
- c. Secila palë do të caktojë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të marrëveshjes. Personat e kontaktit do të janë të disponueshëm për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve.

NENI 6

### **NDRYSHIME**

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin e ndërsjellë, me shkrim të palëve.

Ndryshimet hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Faqe 3 nga 4

NENI 7

**KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES**

- a. Kjo marrëveshje lidhet pa një afat të caktuar dhe, secila nga palët, ka të drejtën të përfundojë në çdo kohë marrëveshjen me një njoftim me shkrim drejtuar palës tjetër 30 (tridhjetë) ditë përpara.
- b. Përfundimi i kësaj marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor, pas marrjes së njoftimit me shkrim nga pala tjetër.

NENI 8

**HYRJA NË FUQI**

Marrëveshja e bashkëpunimit hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj, nga palët.

Ajo përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, nga 2 (dy) për secilën palë.

Për

**MINISTRINË E MBROJTJES**

Kolonel Fadil Çekolli



Për

**MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Zaimra Gjini

